VENDIM
Nr. 419, datë 8.7.2021

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK PËRFITON NGA MASAT MBËSHTETËSE, NË DIGËN E QYRSAQIT, HEC VAU I DEJËS, QARKU SHKODËR, NGA KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH SHA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në digën e Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, Qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH, sh.a.), me elementet, si më poshtë vijon:

a) emri i aplikuesit: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.);

b) NIPT/NUIS i aplikuesit: J61817005F;

c) tipi centralit: Fotovoltaik;

ç) kapaciteti i instaluar: 5.143 mwp;

d) afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut fotovoltaik do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në digën e Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, qarku Shkodër;

e) afati i miratimit të ndërtimit: 48 (dyzet e tetë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;

ë) koordinatat e tokës sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuara prej saj, kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht, çdo 3 (tre) muaj, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ose institucioneve të tjera të autorizuara prej saj, informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. detyrimin e dorëzimit të sigurimit të kontratës, në masën jo më pak se 5 (pesë) % të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj.

iv. të japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.), duhet t'i derdhë tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKSI 1
PLAN-VENDOSJA E SIPËRFAQES SË OBJEKTIT

Pika	Koordinatat Gauss-Kruger
1	4387134.839; 4654365.533
2	4387492.655; 4654428.567
3	4387239.040; 4654175.274
4	4387436.758; 4654318.596